



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 neni 4 paragrafi 4 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Shpall:

KONKURS
I BRENDSHËM

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar i lartë për bashkëpunim territorial
Departamenti	Bashkëpunim dhe Zhvillim Regjional
Divizioni:	Bashkëpunim ndërkufitar
Orari i punës:	Orar i plotë i punës
Koeficienti:	8
Raporton tek:	Udhëheqësi Divizionit për Bashkëpunim Ndërkufitar
Lloji i pozitës:	I/E karrierës
Mbikëqyrja e stafit:	0
Referenca:	MPL/160

Qëllimi i vendit të punës :

1. Koordinimi i aktiviteteve me vendet fqinje dhe Zyrën e BE-se për programimin dhe zbatimin e programeve të bashkëpunimit territorial (Transnacional) dhe monitorimin e këtyre programeve.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Zhvillon dhe ndihmon në procedimin e marrëveshjeve financiare vjetore dhe/apo shumëvjeçare, si dhe në përmbushjen e procedurave qeveritare në mënyrë që të sigurohen fonde për programet e bashkëpunimit territorial/Transnacional;
2. Kryen detyra të specializuara, sipas kërkesës, në fushën e bashkëpunimit territorial/Transnacional në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara dhe ndihmon në sigurimin e asaj që financimi për çdo program është siguruar në buxhetin e shtetit të ministrisë relevante (MAPL-së) me qëllim të bashkëfinancimit;
3. Kryen detyrat në fushën e bashkëpunimit territorial/Transnacional në këtë fushe

me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohë pakohshme dhe ndihmon në programimin, zbatimin dhe monitorimin e programeve për bashkëpunim territorial/Transnacional;

4. Bën hulumtime dhe analiza sipas kërkesës dhe kontribuon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim nga nivelet më të larta dhe përgatit dokumentacionin për raportet për programet territorial/Transnacional;
5. Merr pjesë në grupe punuese në fushën e bashkëpunimit territorial/Transnacional kur kërkohet një gjë e tillë.
6. Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët;
7. Raporton rregullisht te mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën e bashkëpunimit territorial/Transnacional të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

Njohuri të thellë në fushën e bashkëpunimit territorial/Transnacional të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;

Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;

Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ;

Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;

Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Njohja e gjuhës angleze obligative;

Diplomë universitare në shkencat shoqërore: ekonomi, juridik, administratë publike dhe fushë tjetër relevante në shkencat shoqërore, minimum 3 vite përvojë pune profesionale.

Aktet ligjore dhe aktet nën -ligjore që rregullojnë rekrutimin

Rekrutimin e nëpunësve civil e rregullon Ligji Nr. 03/L -149 Për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë .

Kohëzgjatja e emërimit

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit është në përputhje me LSHCK Nr. 03/L-149, në të cilën është e përfshirë periudha e punës provuese një vjeçare.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Formularët zyrtar për aplikim merren në Divizionin e Burimeve Njerëzore të MAPL-së, Kati XII -zyra 1203 , ndërtesa e ish-Rilindja, gjithashtu mund të tërhiqen edhe nga ueb - Faqja e MAPL -së **mapl.rks-gov.net**.

Kushtet për pjesëmarrje ne rekrutim

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmive për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat etj, mund të dorëzohen drejtpërdrejtë në Divizionin e Burimeve Njerëzore të MAPL-së dhe përmes postës. Aplikacionet e pranuar pas afatit të caktuar, konsiderohen të pranueshme nëse data në dërgesën postare, dëshmon se ajo është dërguar(postuar) para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Aplikacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i plotësuar gabueshëm, do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në konsiderim.

Procedura e Konkurrimit

Procedura e konkurrimit është e brendshme vetëm për nëpunësit civil të MAPL-së. MAPL, ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda MAPL-së.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër/ ngushtë do të kontaktohen. Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e publikimit përkatësisht prej datës **17. 05. 2016 deri më datën 24.05.2016.**

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në ueb-Faqen e Ministrisë: **mapl. rks -gov.net**

Për informata shtesë mundë të kontaktoni Zyrën e Personelit të MAPL-së, në telefonin: **038-200 35-568.**